

Treguesit e Shëndetit Publik

Viti 2024

Tiranë, më 14 Nëntor 2025: Ky botim paraqet tregues kryesorë mbi kujdesin shëndetësor parësor dhe shërbimin spitalor dytësor. Për herë të parë, botimi paraqet dhe tregues të aksidenteve në punë.

Kujdesi Shëndetësor Parësor

- Gjatë vitit 2024, numri gjithsej i vizitave në kujdesin parësor ishte 8.951.864, duke shënuar një rënie prej 3,1 %, krahasuar me vitin paraardhës. Nga totali i vizitave:
 - 42,5 % u realizuan në qendrat shëndetësore;
 - 23,9 % u realizuan në ambulanca;
 - 33,6 % u realizuan në poliklinika.
- 35,4 % e vizitave në qendrat shëndetësore dhe ambulanca janë kryer nga persona mbi 60 vjeç.

Konsultori i gruas

- Në vitin 2024, u regjistruan gjithsej 184.801 vizita në konsultorin e gruas, me një rënie prej 9,2 %, krahasuar me vitin 2023.
- Në konsultorin e gruas, 78,1 % ishin vizita obstetrikale dhe 21,9 % e vizitave ishin vizita gjinekologjike.
- Prej vizitave obstetrikale, gjysma e tyre (50,4 %) u realizuan me asistencë të mjekut specialist.
- Gjatë vitit 2024, 15,9 % e vizitave obstetrikale gjithsej u kryen për herë të parë, duke shënuar një rritje prej 4,6 %, krahasuar me vitin paraardhës.


Konsultori i fëmijës

- Në vitin 2024, në konsultorin e fëmijëve u regjistruan 267.048 fëmijë dhe u kryen 731.277 vizita, mesatarisht 2,7 vizita për fëmijë, në vit.
 - Krahasuar me vitin 2023, numri i vizitave është ulur me 1,0 %;
 - 52,9 % e vizitave u realizuan me asistencë të mjekut specialist, dhe pjesa tjetër me asistencë të mamive dhe infermierëve.
- Gjatë vitit 2024, numri i fëmijëve 0-1 vjeç, që ushqehen vetëm me gji, ishte 15.068, ndërsa numri i fëmijëve që ushqehen vetëm me ushqim artificial, ishte 3.459.
- Në vitin 2024, mbulimi vaksinal i fëmijëve, brenda vitit të parë të jetës, mbeti në nivele të larta, 97,0 %-99,0 %, për të gjitha vaksinat sipas skemës kombëtare të vaksinimit, me përjashtim të Fruth-Rubeolë-Parotit, ku mbulimi vaksinal ishte 92,0 %.

Shërbimi spitalor dytësor

- Në vitin 2024, numërohen 65 spitale në vend, nga të cilët 41 janë spitale publike dhe 24 spitale private.
- Në vitin 2024, në institucionet publike të shërbimit spitalor u shtruan 299.318 pacientë, duke shënuar një rritje prej 4,8 % më shumë të shtruar, krahasuar me vitin 2023.
- Gjatë vitit 2024, në institucionet publike të shërbimit spitalor, ishin në dispozicion 8.911 shtretër, ku:
 - Shfrytëzimi i shtratit ishte 176,7 ditë, të cilat përbëjnë 48,4 % të ditëve kalendarike të vitit 2024;
 - Ditët e qëndrimit mesatar të një pacienti janë 4,7 ditë në vit, me një xhiro të shtratit 37,8 herë pacientë në vit.
- Në shërbimin spitalor, u kryen gjithsej 65.302 ndërhyrje kirurgjikale, me një rritje prej 0,4 %, krahasuar me vitin 2023.

Fig. 1 Pacientë të dalë dhe ditë mesatare të qëndrimit në institucionet publike të shërbimit spitalor



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Aksidente në punë

- Në vitin 2024, janë regjistruar 224 inspektime për shkak aksidenti në punë, duke shënuar një rritje prej 2,8 %, krahasuar me vitin paraardhës.
- Numri i punëmarrësve të aksidentuar në punë, ishte 177, një rritje prej 5,4 %, krahasuar me vitin 2023.
 - 18,6 % e punëmarrësve të aksidentuar ishin femra
- Për aksidentet fatale, gjatë vitit 2024 u shënuan 33 punëmarrës të aksidentuar në punë me vdekje, 3 aksidente më shumë, krahasuar me vitin paraardhës.
 - 6,1 % e punëmarrësve të aksidentuar me vdekje ishin femra

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të INSTAT: [Treguesit e Shëndetit Publik, 2024](https://www.instat.gov.al)

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <https://www.instat.gov.al/>

Metodologjia

Botimi “**Treguesit e Shëndetit Publik**” përmban të dhëna administrative mbi shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor dhe shërbimin spitalor dytësor, me frekuencë vjetore dhe burim Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Ky botim përfshin për herë të parë dhe tregues lidhur me akcidentet në punë, bazuar në inspektimet e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Kujdesi parësor përfshin të dhëna mbi aktivitetin e ambulancave, qendrave shëndetësore, poliklinikave, si dhe shërbimet e konsultorit të gruas dhe të fëmijës, që mbulojnë kujdesin parandalues dhe bazë për popullsinë. Kujdesi dytësor spitalor përfshin informacion mbi numrin e pacientëve të shtruar, shfrytëzimin e shtretërve dhe aktivitetin kirurgjikal, duke pasqyruar kapacitetet dhe performancën e sistemit spitalor gjatë vitit referues. Të dhënat mbi shërbimin vaksinal kanë burim informacioni Institutin e Shëndetit Publik.

Përkufizime

Aksident në punë ose për shkak të punës është çdo ngjarje e papritur, që shkakton dëmtimin e menjëhershëm trupor, që ndodh gjatë kryerjes së punës apo të një shërbimi lidhur me të, si dhe çdo dëmtim tjetër i shëndetit, që nuk rrjedh nga sëmundje e përgjithshme, por që sjell paaftësi të përkohshme ose të përhershme në punë ose vdekje.

Ditë shtretër të realizuar është shumëzimi i shfrytëzimit të shtratit në ditë me numrin e shtretërve në spital.

Qendrat e kujdesit shëndetësor parësor janë të gjitha institucionet shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për pacientët në mënyrë ambulante, të cilat janë të pajisura me të paktën një personel mjekësor, mjek ose infermier (nuk përfshihet shërbimi i stomatologjisë).

Kujdesi shëndetësor parësor i ofrohet popullatës nga njësi bazë e tij, që njihet si qendra shëndetësore dhe ambulanca, si pika e parë e kontaktit me sistemin kombëtar të kujdesit shëndetësor.

Spitali është një rezidencë institucionale që ofron kujdes mjekësor, hoteleri 24 orë, diagnostikim, trajtim dhe rehabilitim të të sëmurëve që mund të kenë nevojë për ndihmë mjekësore ose kirurgjikale.

Shtretër spitalorë janë shtretër për akomodimin e pacientëve, ku përfshihen katër tipe shtretërish sipas funksionit: shtretër kurativë, shtretër rehabilitues, shtretër kronikë dhe paliativë si dhe shtretër të tjerë të paklasifikuar. Totali i numrit të shtretërve i referohet numrit në të gjitha spitalet, përfshirë spitalet e përgjithshme, spitalet e shëndetit mendor dhe të abuzimit me substancat, spitalet e specialitetit, pavarësisht nëse krevati është i zënë apo jo.

Shfrytëzimi i shtratit në ditë është numri i ditëve mesatare të vitit gjatë të cilave një shtrat i spitalit është i zënë me pacientë.

Të shtruar janë pacientë të cilët janë pranuar formalisht në një institucion për trajtim ose kujdes, dhe që qëndrojnë për të paktën një natë.

Xhiro e një shtrati është numri i të sëmurëve që janë shtruar në një shtrat gjatë vitit.